



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Në mbështetje të Rregullores së MF. nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ, Vendimin nr. 4/2024 të datës 18/1/2024 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë për thirrjen publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, Vendimit nr. 28 të datës 15/03/2023 të Sekretares të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë për themelimin e komisionit vlerësues për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare publike të OJQ-ve, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHEN** kërkesat e OJQ-ve sipas thirrjes publike të datës 7/3/2024 të Ministrisë së Drejtësisë për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2024 (si më poshtë nga nr. 1-2):
 1. Fondacioni Terre dess hommes Lausanne në Kosovë;
 2. Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjilanit

Arsyetim

OJQ-të sipas pikës I të këtij vendimi nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë përkitazi me thirrjen publike të Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk kanë plotësuar të gjitha kriteret e parapara me këtë thirrje dhe Rregulloren përkatëse, andaj Komisioni ka vendosur për mos financimin e projekteve të propozuara.

OJQ-të nga pika I e këtij vendimi, respektivisht, Fondacioni Terre dess hommes Lausanne në Kosovë dhe OJQ, Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjilanit me rastin e aplikimit nuk kanë ofruar dëshmi që janë të licencuara në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, ashtu siç kërkohet në pikën 3, përkatësisht 3.1 të thirrjes publike të datës 7/3/2024, ku thuhet:

- Organizatat jo-qeveritare e licencuara mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:
Strehim dhe Shërbim për fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar dhe neglizhuar;

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: OJQ-të e pakënaqura me këtë Vendim mund të parashtrojnë ankesë me shkrim në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë, në afat prej 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij Vendimi në ueb-faqen e MD-së.

Komisioni vlerësues:

Skender Jahaj _____
Ilir Mazreku _____
Fjolla Sojeva _____
Fehmi Ibrahim _____
Almedine Jaha _____